

*Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

➤ **Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

1. Koordinon dhe ndjek zbatimin e kuadrit rregullator të përcaktuar në ligjin për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, dokumentin e politikave, për qeverisjen e sektorit të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri dhe aktet nëligjore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
2. Koordinon nismat apo projektet për investime të autoriteteve publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore apo ngritjen e sistemeve të informacionit gjeohapësinor;
3. Menaxhon projektet e brendshme, ato me autoritetet publike përgjegjëse apo donatorë të huaj, që lidhen me sektorin e gjeoinformacionit;
4. Drejton procesin e hartimit të raporteve dhe analizën e riskut mbi realizimin e projekteve dhe produktet e përfuara nga projektet në fushën e gjeoinformacionit;
5. Bashkëpunon me strukturat brenda ASIG, sipas fushës së tyre të përgjegjësive, për hartimin dhe përditësimin e projektakteve që lidhen me rregullat dhe standardet e sektorit të gjeoinformacionit;
6. Drejton procesin e punës për përgatitjen e rekomandimeve lidhur me masat ligjore dhe organizative për ndryshimin e legjislacionit dhe përputhjen e tij me aktet komunitare;
7. Menaxhon procedurat përkatëse në rolin e sekretariatit Teknik të BIG, në përputhje me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor - BIG”, të miratuar me Urdhër të Kryeministrit;
8. Bashkëpunon me strukturat brenda ASIG, sipas fushës së tyre të përgjegjësive, për formulimin e kërkesave apo propozimeve për BIG-un lidhur me nismat dhe projektet e autoriteteve publike përgjegjëse, në fushën e gjeoinformacionit;

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

- Të zotërojë diplomë “Master shkencor” në Shkenca Juridike;
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune;
- Të njohë legjislacionin vendor dhe të BE lidhur me infrastrukturën kombëtare të Informacionit gjeohapësinor;
- Të ketë aftësi të mira propozimi e menaxhimi të projekteve vendore dhe me partnerë të huaj;
- Të ketë marrë pjesë apo kontribuar në hartim politikash, strategjish dhe implementim të tyre;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese;
- Të ketë njohuri për parimet dhe praktikat administrative;
- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit;
- Vlerësohen certifikimet për sa më lart.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (II-b)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 19.06.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit [info@asig.gov.al](mailto:info@asig.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.